

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Arti muzikor* për vitin II (e dytë) për arsimin e mesëm në gjimnaz për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *Arti Muzikor* për vitin II (e dytë) për gjimnaz bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen njësitë e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 2 orë në javë parashikohen 64 orë në programin e shkurtuar me kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyra e temave dhe përmbajtjeve mësimore

Tema/Fusha

1. Historia e muzikës 46 (47) orë

Përmbajtjet mësimore

1 - Romantizmi muzikor (paraqitja dhe karakteristikat);

2 - F. Shubert; - Miniaturë solo e këngës dhe pianos (forma muzikore);

- 3 - R. Shuman;
- 4 - F. Mendelson;
- 5 - J. Brams;
- 6 - R. Shtraus;
- 7 - Muzika programore dhe absolute,
- H. Berlioz;
- 8 - Franc List;
- 9 - Analiza e krijimtarisë;
- 10 - Opera e Romantizmit në - Itali, Gjermani, Francë;
- 11 - Xhoakino Rosini, Viçenco Belini, Gaetano Doniceti;
- 12 - Xhuzepe Verdi;
- 13 - K.M. Veber;
- 14 - R. Vagner;
- 15 - Zhorzh Bize;
- 16 - Verizmi në operën italiane Maskanji, Leonkavelo dhe Puçini;
- 17 - Analiza e krijimtarisë;
- 18 - Romantizmi në vendet sllave;
- 19 - Romantizmi në Poloni përmes veprës së F. Shopen;
- 20 - Romantizmi në Rusi - M. Glinka dhe „Pesëshja ruse“;

- 21 – Petar Iliç Çajkovski;
- 22 – Romantizmi në Çeki – Bedzhih Smetana;
- 23 – Antoninj Dvorzhak;
- 24 - Romantizmi në Norvegji, Finlandë dhe Spanjë (Eduard Grik,Jan Sibelijus, Manuel de Fala);
- 25 – Analizë e krijimtarisë;
- 26 – Impresonizmi muzikor;
- 27 - K. Debisi;
- 28 - Moris Ravel;
- 29 – Analizë e krijimtarisë;
- 30 – Muzika në shekullin 20;
- 31 - I. Stravinski;
- 32 – Sergej Prokofjev;
- 33 – Arnold Shenberg;
- 34 – Analizë e krijimtarisë;
- 35 – Muzika maqedonase në shekullin 20;
- 36 - Brezi i parë i kompozitorëve Stevan Gajdov, Zhivko Firfov;
- 37 - Trajko Prokopiev dhe Todor Skalovski,
 - Folklor maqedonas në stile moderne (muzikë popullore);
- 38 - Kompozitorët maqedonas pas Luftës së Dytë Botërore - V. Nikollovski, T. Proshev;

- 39 - Paraqitja e muzikës operistike në Maqedoni përmes veprës së K. Makedonski;
- 40 - Paraqitja e muzikës së baletit në Maqedoni dhe vepra e Ljubomir Brangiolica;
- 41 - Analizë e krijimtarisë;
- 42 - Shfaqja e muzikës xhaz;
- 43 - J. Gershvin;
- 44 - Muzikë argëtuese (muzikë filmike dhe dramatike);
- 45 - Stilet dhe zhanret moderne në shekullin e 20-të;
- 46 - Analizë e krijimtarisë;

Tema/Fusha

2. Krijimtaria muzikore popullore 6 (7) orë

Përmbajtjet mësimore

- 1 - Kostumet dhe zakonet si pjesë e thesarit tonë folklorik;
- 2 - Motivi i ndarjes dhe migrimit të punës në muzikën popullore;
- 3 - Kënga origjinale popullore dhe kënga e sapokrijuar me elemente folklorike;
- 4 - Përpunimi i këngës popullore;
- 5 - Kënga dhe zanafilla;
- 6 - Analiza e artit popullor.

Tema/Fusha

3. Format muzikore 6 (7) orë

Përmbajtjet mësimore

- 1 - Këngë e vogël dypjesëshe dhe trepjesëshe;
- 2 - Këngë komplekse me tre pjesë (mazurkë, menuet, marsh);
- 3 - Suitë, sonatë, koncert dhe fuga;
- 4 - Sonata dhe simfonia klasike;
- 5 - Opera, operetë, balet;
- 6 - Analiza e punës së muzikës - vepra skenike.

Tema/ Fusha

3. Teoria e Muzikës 4 (4) orë

Përmbajtjet mësimore

- 1 - Zbulimi i qarkut të kuintës lartë-poshtë me bemol dhe diez;
- 2 - Shkalla -dur me tre parashenja A - dur; Es-dur,
- Këngë në shkallët e reja tonike (interpretimi vokal);
- 3 - Shkallët mol me tre parashenja fis-moll, c-moll;
- 4 - Analizë e teorisë së muzikës.

Tema/Fusha

5. Interpretimi vokal 6 (7) orë

Përmbajtjet mësimore

- 1- Këngët popullore artistike dhe revolucionare;
- 2- Fragmente të operave dhe simfonive të njohura;
- 3- Krijimtaria muzikore.

3.Rekomandimet didaktike

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Arti muzikor për vitin II (e dytë) për gjimnaz do të realizohet për 159 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 64 orë mësimore në kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta. Përmbajtjet mësimore të programit mbeten të njëjta por të radhitura në kuadër të 64 orë mësimore. Është bërë bashkimi i përmbajtjeve mësimore të temave të njëjta dhe të ndryshme me ndërlidhje logjike mes tyre. Ndërlidhen përmbajtjet mësimore ; F. Shubert” (Historia e muzikës) me „Këngaë solo dhe miniatura e pianos (format muzikore), „Muzika programore dhe absolute” (Historia e muzikës) me „Hektor Berliuz” (Historia e muzikës), „Shkallët-dur me tre parashenja A-dur, Es – dur” (Teoria e muzikës) me „ Këngë në shkallët e reja tonike” (Interpretimi vokal), dhe Trajko Prokopiev dhe Todor Skallovski” (Historia e muzikës) me „Folklori maqedonas në stile moderne” (krijimtaria muzikore popullore).

Në këtë program numri i orëve jepet në një orientim i cili i lë hapësirë mësimdhënësit për të shprehur krijimtarinë dhe përshtatjen e tij ndaj kushteve materiale - teknike dhe hapësinore, aktiviteteve të ndryshme dhe përshtatjes së mësimdhënies me situatën e re në të gjithë botën shkaktuar nga virusi Covid -19. Për shkak të kësaj, mësimdhënësit i jepet mundësia, jo vetëm në temat dhe përmbajtjet e parashikuara, të jetë në gjendje të bëjë shkurtimin - pra integrimin, por edhe në temat dhe përmbajtjet e tjera sipas krijimtarisë dhe nevojave të tij.

Nuk ka një qasje të unifikuar në përgatitjen e planeve për realizimin e programeve mësimore për lëndën e arsimit muzikor. E nevojshme është që secili mësimdhënës të kombinojë individualisht përmbajtjen mësimore të temave të njëjta dhe të

ndryshme sipas nevojave reale për realizimin e mësimdhënies, në të njëjtën kohë duke marrë parasysh lidhjen logjike midis tyre. Rekomandohet që mësimdhënësit t'i kushtojë vëmendje fushëveprimit të materialit mësimor gjatë realizimit të orës në të cilën ai ka integruar dy ose më shumë përmbajtje mësimore. Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, koncepte të caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në mësimin e rregullt duke marrë parasysh kohëzgjatjen e mësimit prej 35 minutash. Monitorimin e arritjeve të nxënësve secili mësimdhënës individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të planifikuara për realizim, duke përdorë metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në përputhje me normën për kuadrin mësimor të dhënë në programin mësimor të rregullt.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën arti muzikor për vitin e parë në arsimin e mesëm - gjimnaz e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
